

REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E SHëndETËSISË  
DHE MIRëQENIES SOCIALE

# BULETINI M U J O R I

QERSHOR 2026



## ► ***Inaugurohet SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, kushte moderne dhe shërbime të zgjeruara për nënat dhe fëmijët***

Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” është transformuar tërësisht, duke u kthyer në një qendër moderne të kujdesit për gratë dhe të porsalindurit, me standarde bashkëkohore europiane. Investimi ka sjellë ambiente tërësisht të rikonstruara, pajisje të teknologjisë së avancuar dhe kushte më dinjitoze si për pacientët, ashtu edhe për stafin mjekësor, duke forcuar më tej cilësinë dhe sigurinë e shërbimit shëndetësor. Në ceremoninë e inaugurimit të ambienteve të reja morën pjesë Kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, të cilët vlerësuan investimin si një hap të rëndësishëm në modernizimin e sistemit shëndetësor dhe rritjen e cilësisë së kujdesit për gratë dhe të porsalindurit.



## ► *Nis konsultimi publik për krijimin e Institutit Kombëtar të Onkologjisë*

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, në tryezën e diskutimit të organizuar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë, prezantoi prioritetet strategjike të Ministrisë dhe reformat kryesore që po transformojnë sistemin shëndetësor shqiptar. Gjatë fjalës së saj, ministrja Sala bëri të ditur se ka nisur procesi i konsultimit për Vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e Institutit Onkologjik Kombëtar, një prej reformave më të rëndësishme në fushën e onkologjisë. Ajo theksoi se paralelisht po ndërtohet Rrjeti Kombëtar i Onkologjisë, me synimin që pacientët të kenë akses në kujdes të koordinuar dhe shërbime sipas standardeve në të gjithë vendin.



## ► Lançohet Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030

Në Ditën Botërore të Fëmijëve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë, lançoi Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030, një dokument strategjik që synon forcimin e sistemit të mbrojtjes dhe fuqizimin e të drejtave të çdo fëmije në Shqipëri. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala, në aktivitetin e organizuar për promovimin e kësaj agjende, theksoi rëndësinë e një qasjeje të re dhe gjithëpërfshirëse ndaj fëmijërisë, duke vendosur në qendër sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve.



## ► 38 prorokolle kombëtare për kancerin, ministrja Sala: Unifikojmë kujdesin onkologjik në të gjithë vendin

Për herë të parë në Shqipëri, po ndërtohet një gjuhë e vetme klinike për trajtimin e kancerit: 38 udhërrëfyes kombëtarë që do të shndërrohen në protokolle detyruese, në të gjitha spitalet bashkiake dhe rajonale në mënyrë që çdo pacient, kudo që jeton, të marrë të njëjtin standard kujdesi si në qendrat më të mira europiane. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala gjatë inspektimit në Spitalin Bashkiak Librazhd dhe Pogradec tha se 38 udhërrëfyesit për tumoret, të miratuara në bashkëpunim me Institutit e Tumoreve në Milano do të kthehen në protokolle klinike që do të përdoren në të gjithë sistemin shëndetësor shqiptar, duke garantuar që çdo vendim mjekësor të mbështetet në evidencën më të avancuar shkencore dhe në standardet më të mira europiane.



## ► **Miratohet Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030**

Këshilli i Ministrave miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030, dokumentin strategjik që do të udhëheqë politikat publike për garantimin e të drejtave, përfshirjes sociale dhe jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara gjatë pesë viteve të ardhshme. I hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, Plani përfaqëson angazhimin e Qeverisë Shqiptare për ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse, më të aksesueshme dhe më të drejtë për të gjithë.



► **36 qendra shëndetësore verore në shërbim 24/7, nis për herë të parë zbatimi i tarifave të unifikuara për turistët**

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, gjatë inspektimit në Qendrën Shëndetësore Verore të Pogradecit, bëri të ditur se këtë sezon turistik janë në funksion 36 qendra shëndetësore verore në të gjithë vendin, të pajisura me staf mjekësor, barna dhe pajisje të nevojshme do të ofrojnë shërbim të pandërprerë 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, për qytetarët dhe turistët. Gjatë vizitës, ministrja njoftoi gjithashtu nisjen e zbatimit të një kuadri të ri të unifikuar për regjistrimin, trajtimin, tarifimin dhe dokumentimin e shërbimeve shëndetësore të ofruara për shtetasit e huaj në institucionet shëndetësore publike.



## ► **Ministrja Sala bashkëbisedim me fëmijët mbi risitë e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030**

Me nismën e Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve do të zhvillojë mbledhjet e tij periodike në shkolla të qyteteve të ndryshme të vendit, duke përfshirë drejtpërdrejt në diskutime nxënës të arsimit parauniversitar dhe gjimnazistë. Takimi i parë jashtë institucionit u zhvillua në Gjimnazin "Petro Nini Luarasi", ku ministrja Sala bashkëbisedoi me nxënës, mësues dhe anëtarë të Këshillit mbi prioritetet e Agjendës Kombëtare të të Drejtave të Fëmijëve 2027–2030, duke theksuar rëndësinë e dëgjimit të zërit të fëmijëve dhe të rinjve në hartimin e politikave që i prekin ata.



► **Forumi botëror i “The Economist”, ministrja Sala: Shqipëria, reforma të thella për një sistem shëndetësor më të fortë dhe më gjithëpërfshirës**

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala mori pjesë në forumin e 11-të botëror të kancerit 2026, organizuar nga revista prestigjioze “The Economist”, ku u diskutuan sfidat dhe zgjidhjet për garantimin e aksesit të barabartë në kujdesin ndaj kancerit në të gjithë Evropën. Gjatë fjalës së saj, ministrja Sala theksoi se pabarazitë në trajtimin e kancerit nuk mund të adresohen përmes reformave të fragmentuara, por kërkojnë transformim të plotë të sistemit shëndetësor, duke përfshirë parandalimin, depistimin, diagnostikimin e hershëm, trajtimin dhe kujdesin pas trajtimit



## ► *Spitali Universitar i Traumës vijon ofrimin e shërbimit shëndetësor pa ndërprerje*


Në Spitalin Universitar të Traumës po vijon puna për një nga projektet më të rëndësishme të modernizimit të infrastrukturës spitalore në vend. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala dhe Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi inspektuan ecurinë e punimeve në këtë spital, i cili paralelisht vijon ofrimin e kujdesit shëndetësor pa ndërprerje, ndërsa stafi mjekësor është i angazhuar me dy turne për të garantuar shërbim cilësor dhe të sigurt për çdo pacient.



## ► **Ministrja Sala vizitë në Qendrën Multifunktionale në Librazhd: Shërbime të specializuara për fëmijët me aftësi të kufizuara**

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala dhe kryetari i Bashkisë Librazhd, Mariglen Disha, vizituan Qendrën Multifunktionale për Personat me Aftësi të Kufizuara, një model shërbimi gjithëpërfshirës dhe dinjitoz, i ngritur përmes mekanizmit të Fondit Social, që synon fuqizimin, rehabilitimin dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuara në komunitet. Gjatë vizitës, ministrja Sala vlerësoi rëndësinë e shërbimeve komunitare të integruara, të cilat mbështesin jo vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara, por edhe familjet e tyre, përmes kujdesit të specializuar dhe ekipeve multidisciplinare.





REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E SHëndETËSISË  
DHE MIRëQENISë SOCIALE

# BULETINI M U J O R I

QERSHOR 2026